



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE INFORMIMIT PUBLIK

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE NGRITJES NË DETYRË**

DREJTOR NË DREJTORINË E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Ne zbatim të nenit 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe kreut II, III, IV dhe V, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, Bashkia Patos shpall Procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në shërbimin civil për pozicionin:

një vënd në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Projekteve dhe Emergjencave Civile, kategoria e pagës II-2.

Pozicioni i më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë për nëpunësi e kategorisë së ulët drejtuese

Për të dy Procedurat (lëvizje paralele dhe pranimin në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

LËVIZJE PARALELE

18/11/2024

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

NGRITJE NË DETYRË

21/11/2024

• **Përshkrimi përgjithësues i pozicionit të punës së mësipërm:**

1. Menaxhon veprimtarinë e drejtorisë për hartimin e politikave dhe koordinimin e strategjisë së zhvillimit të bashkisë.
2. Merr masa për harmonizimin e planeve dhe strategjive të zhvillimit të bashkisë, me planet kombëtare dhe rajone të zhvillimit.
3. Menaxhon punën për hartimin e projekteve dhe preventivave për rikonstruksione dhe ndërtime rruge, trotuare, lulishte, kanalizime, ujësjellesa, objekte ekonomike, arsimore dhe social-kulturorë etj.
4. Ndjek vazhdimisht në terren procesin e zbatimit të projekteve të hartuara, duke sqaruar e I dhënë zgjidhje problemeve që dalin gjatë realizimit të projektit.
5. Koordinon me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Monitorimit të Shërbimeve pranë bashkisë, për projektet që nevojiten për përmirësimin e infrastrukturës dhe investimet e reja publike me financime të brendshme, buxhetore apo të huaja.
6. Kontrollon në terren realizimin e objekteve, si dhe mban lidhje me supervisorët dhe kolaudatorët e investimeve në infrastrukturën e bashkisë.
7. Përgatit raporte, projekte, studime dhe analiza, që ndihmojnë në hartimin dhe zbatimin e objektivave dhe prioritetëve të planeve strategjike të zhvillimit.
8. Bashkërendon punën, ndihmon sektore të tjerë të bashkisë në përshtatje të punës së tyre për realizimin e objektivave dhe prioritetëve të planeve strategjike të zhvillimit.
9. Grumbullon dhe sistemon të gjithë dekontacionin që përdoret gjatë hartimit të strategjisë dhe të programeve të zhvillimit si dhe zbatimin e tyre.
10. Tërheq projekte dhe donator të ndryshëm në fushat prioritare të identifikuar në strategjinë e zhvillimit të qytetit.
11. Merr masa për harmonizimin e planeve dhe strategjive të zhvillimit të bashkisë, me planet kombëtare dhe rajone të zhvillimit.
12. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak për probleme që kanë lidhje me drejtorinë.
13. Harton programet e punës mujore, duke planifikuar punën për muajin pasardhës.
14. Kryen vlerësimin e punonjësve të Drejtorisë së tij çdo 6 muaj.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e lëvizjes paralele janë:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori,
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të zotëroj diplomë të nivelit të dytë në Inxhinierin e Ndërtimit (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi, diploma Bachelor dhe Master Shkencor duhet të jene në të njëjtën degë*).
- b. Të kenë përvojë në punë 5 (pesë) vjet.

- c. Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (Microsoft Office, Autocat, dhe programe të tjera inxhinierike).
- d. Njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të dërgojë dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, këto dokumenta:

- a. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- b. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- c. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- h. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i. Fotokopje të aktit të konfirmimit të Statusit të nëpunësit civil.
- j. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- k. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.11.2024.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **18.11.2024**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpall në portalin e “Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe në stenden e informimit të publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e paraqitjes së tyre.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë mbi ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”
- b. Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- c. Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- d. Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- e. Njohuritë mbi ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”;

- f. Njohuritë mbi ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- g. Njohuritë mbi V.K.M-në nr. 97 “Për procedurat e privatizimit të banesave”;
- h. Njohuritë mbi ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- i. Njohuritë mbi ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- j. VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”;
- k. Vendimi nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e zhvillimit të teritorrit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”;
- l. Njohuritë mbi ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë, i ndarë në: 20 pikë përvojë, 10 pikë për trajnime apo kualifikime të lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë, në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohet me 60 pikë.

Totali i pikëve është 100 pikë.

1.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Data dhe vendi i konkurimit do të njoftohet konkurrenteve.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Patos do të shpallë fituesin në Faqen Zyrtare të Bashkisë Patos dhe në portalin e “Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

NGRITJA NË DETYRË

2

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet ngritjes në detyrë, ku mund të marrin pjesë për konkurim edhe kandidatët jashtë shërbimit civil. Këtë informacion do ta merrni në “Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendat pranë Bashkisë Patos.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorise së ulët drejtuese, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të zotërojë një diplomë të nivelit të dytë në Inxhinieri Ndërtimi;
- b. Të kenë përvojë në punë 5 (pesë) vjet.
- c. Të njohin dhe të përdorin programet bazë të punës në kompjuter (Microsoft Office, Autocat dhe programe të tjera inxhinierike).
- d. Njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.
- e. Te kete njohuri te një gjuhe te huaj.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant
- b. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun :
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- c. Fotokopje të diplomës dhe listën e notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h. Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që nuk ke marrë masë disiplinore në fuqi.
- i. Aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit civil në nivelin ekzekutiv
- j. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet

Dokumentet duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në institucionin e Bashkisë Patos, brenda datës 21.11.2024.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **22.11.2024**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos do të shpallë në portalin e Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe ne stenden e informimit te publikut listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Kandidatët, të cilët rezultojnë të pakualifikuar, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e njoftimit individua, paraqesin ankesat me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos. Ankesat zgjidhen brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e depozitimit të ankesës.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohurite mbi ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”
- b. Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar) si dhe aktet nëligjore dalë në zbatim të tij;
- c. Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- d. Njohuritë mbi ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- e. Njohuritë mbi ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”;
- f. Njohuritë mbi ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- g. Njohuritë mbi V.K.M-në nr. 97 “Për procedurat e privatizimit të banesave”;
- h. Njohuritë mbi ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- i. Njohuritë mbi ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”;
- j. VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”;
- k. Vendimi nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe proçedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e zhvillimit të teritorrit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”;
- l. Njohuritë mbi ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë, i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Totali i pikeve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pike të cilat ndahen perkatesisht:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë;

2.6

DATA E KONKURIMIT DHE DALJA E REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil për kategorinë e mesme drejtuese, do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Patos, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil të kategorisë së mesme drejtuese - për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak, - datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi; Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Patos duke filluar nga data 27/11/2024.

DREJTORE
Juela Shpata